



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 845/Prot.
13

Tiranë, më 05.12.2025

VENDIM
Nr. 75, datë 05.12.2025

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR.50, DATË 10.11.2025

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, ndryshuar me vendimin nr. 158, datë 30.12.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Drejtorisë së Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr.50, datë 10.11.2025, të Komisionerit, "Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, në lidhje me veprimet administrative të kryera gjatë procesit të ecurisë disiplinore, në institucionin e Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar",

KONSTATOVA SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është regjistruar informacioni me shkresën nr. 845 prot., datë 8.10.2025, paraqitur nga nëpunësja Florina Hajredinaj, me detyrë "Përgjegjës i Sektorit të Regjistrimit të Biznesit", pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, përmes të cilit ngrihen pretendime nga ana e nëpunëses, për parregullsi të kryera në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë procedurës së dhënies së masës disiplinore "Largim nga shërbimi civil", në ngarkim të saj.

Pas verifikimit të informacionit, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ, bazuar në nenin 16, Kreu III "Procedura paraprake", të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, ndryshuar me vendimin nr. 158, datë 30.12.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-Hotel Drini, Tiranë, Tel: 00355 4268141, Web: www.kmshc.al E-mail: info@kmshc.al

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr.50, datë 10.11.2025, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, në lidhje me veprimet administrative të kryera gjatë procesit të ecurisë disiplinore, në institucionin e Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar”, të Komisionerit.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr.50, datë 10.11.2025, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, vërej se situata e administrimit të shërbimit civil në institucion paraqitet si më poshtë vijon:

Në pikën 1, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka paralajmëruar Qendrën Kombëtare të Biznesit të rikthejë ligjshmërinë duke detyruar Drejtorin e Përgjithshëm që, me një akt të ri me shkrim dhe në zbatim të neneve 108, 110 dhe 111 të Kodit të Procedurave Administrative, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të vendimit nr. 16731/11, datë 3.10.2025, për dhënien e masës “Largim nga shërbimi civil” ndaj Florina Hajredinaj, si dhe të urdhrit nr. 144 (16731/12), datë 3.10.2025, për ndërprerjen e marrëdhënieve të saj financiare.

Konstatohet se, brenda afatit të lënë në vendimin objekt i këtij verifikimi, me shkresën nr. 16731/22 prot., datë 12.11.2025, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 845 prot., datë 14.11.2025, institucioni i Qendrës Kombëtare të Biznesit, ka informuar këtë të fundit në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Konkretisht, vërej se, me Vendimin nr. 16731/17, datë 12.11.2025, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse e Qendrës Kombëtare të Biznesit konstatoi pavlefshmërinë absolute të vendimit nr. 16731/11, datë 03.10.2025, për marrjen e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil” ndaj nëpunëses Florina Hajredinaj, si dhe të Urdhrit nr. 144 (16731/12), datë 03.10.2025, për deklarimin e lirimit nga shërbimi civil dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare për nëpunësen Florina Hajredinaj. Në vijim, me Urdhrit nr. 167, datë 12.11.2025, të së njëjtës drejtorië, u vendos rikthimi i nëpunëses në pozicionin e saj të mëparshëm të punës dhe rregullimi i plotë i efekteve financiare të shkaktuara nga aktet absolutisht të pavlefshme.

Për sa u parashtua më sipër, çmoj se nga ana e institucionit Qendra Kombëtare e Biznesit janë zbatuar detyrat e përcaktuara në Vendimin Paralajmërues nr. 50, datë 10.11.2025, të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së

Shqipërisë” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, ndryshuar me vendimin nr. 158, datë 30.12.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr.50, datë 10.11.2025, të Komisionerit, “*Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, në lidhje me veprimet administrative të kryera gjatë procesit të ecurisë disiplinore, në institucionin e Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar*”.
2. Konstatimin e rregullimit të situatës së ligjshmërisë nga ana e institucionit Qendra Kombëtare e Biznesit, në përputhje me detyrimet e Vendimit nr.50, datë 10.11.2025, të Komisionerit.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Qendrës Kombëtare të Biznesit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësja Florina Hajredinaj.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



